

KONCEPT DOKUMENT
Konferencë Ndërkombëtare
Analizë Rajonale e platformës Pekini+25 për Ballkanin Perëndimor

1. Historiat

Agjenda për fuqizimin e grave dhe vajzave e miratuar në Konferencën e Katërt Botërore për Gratë në vitin 1995 në Pekin, ishte një përgjigje vizionare ndaj përfaqësimit në nivel të ulët në vazhdimësi dhe të theksuar tejmasë të grave dhe pabarazisë gjinore në të gjithë botën, ku dominimi i burrave i kishte lënë gratë jo vetëm të marginalizuara, por edhe të diskriminuara shumë në të gjitha sferat e jetës. Bota ishte praktikisht e 'verbër në aspektin gjinor' duke mos qenë në gjendje të shihte që gratë të cilat përbënin gjysmën e popullatës botërore paraqisnin një aset strategjik për t'u investuar për një të ardhme më të mirë. Kishte nevojë për një agjendë të tillë revolucionare e cila do të kishte efekt të 'hapjes së syve' me qëllim që të kuptohet se sa e rëndësishme është që gratë, si gjysma e kapitalit njerëzor, të marrin rolin dhe përgjegjësinë e tyre në mënyrë të barabartë me burrat për ndërtimin e një të ardhme paqësore, të qëndrueshme dhe të prosperuar për të gjithë.

Konferenca e Pekinit e mbajtur në vitin 1995 ishte një pikë kthese e rëndësishme në fokusin e botës në barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Deklarata e Pekinit dhe Miratimi i Platformës për Veprim ngritën pritshmëri të lartë për realizimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në pragun e një mijëvjeçari të ri.

Ajo që ka ndryshuar ose evoluar në drejtim të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave dhe vajzave në 25 vitet e fundit në të gjithë rajonin është një pyetje që prek interesin e të gjithëve, veçanërisht të grave në të gjithë botën e në veçanti të neve në rajonin e pas konfliktit të Ballkanit Perëndimor.

Rrugëtimi i grave drejt fuqizimit është përshkruar me rezultate të përziera të përparimit dhe stagnimeve në 25 vitet e fundit. Historia specifike e luftës dhe paqes në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe agjenda e Pekinit për fuqizimin e grave ka qenë e ndërlikuar, dhe kështu, ka sjellë nivele të ndryshme të përparimit në fusha të ndryshme të fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore. Aktivizmi i jashtëzakonshëm i grave për të ndihmuar në kapërcimin e kohërave tragjike, duke u përfshirë në lëvizjet çlirimtare dhe të pavarësisë dhe proceset e zgjidhjes së konflikteve, solli besueshmëri përkatëse për gratë si përfaqësuese të ndryshimit. Sidoqoftë, ato u përballën me reagime duke e gjetur veten të lënë anash menjëherë pas konflikteve. Kohërat e paqes u konsideruan nga burrat si "kohë e shprehjes së fuqisë" për ta dhe jo për gratë. Këtë e përjetuam ne grate gjatë periudhës së pas konflikteve, dhe kjo ishte pikënisja jonë e luftës për fuqizim. Në ditët e sotme, ka përparim të grave në përfaqësim në parlamentet kombëtare dhe në nivelin lokal,

megjithëse përmes vendeve të rezervuara dhe jo natyrshëm përmes vetëdijes demokratike. Gratë vazhdojnë të jenë pamjaftueshëm të përfaqësuar në qeveritë dhe nivelet e vendimmarrjes. Është zhgënjyese të shihet se si gratë kanë qenë pothuajse tërësisht të përjashtuara nga proceset zyrtare të paqes të cilat sollën përfundimin e luftërave dhe vendosën paqen në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Drejtësia kalimtare dhe drejtësia ndërkombëtare vazhdojnë të jenë të ngadalta, sepse një nga çështjet më të dhimbshme të përjetuara gjatë luftërave, të grave të përdhunara gjatë luftërave, mbetet ende një problematikë nën sirtar, ndërsa ndëshkimi i autorëve mbetet më shumë si një pakënaqësi sesa një shpresë. Përkundër faktit që gratë janë të përfshira dhe tregojnë performancë të jashtëzakonshme për të ndihmuar në ndërtimin e paqes, qeverisjes demokratike, pajtimit dhe avancimit të grave, agjendës së paqes dhe sigurisë, vuajtjet e tyre në kohë lufte dhe kontributet në kohërat e paqes nuk janë njohur ende plotësisht. Në përgjithësi, gjendja aktuale sa i përket barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave ka shënuar më shumë përparim në aspektin ligjor dhe normativ, përderisa zbatimi praktik ka angelur shumë mbrapa për shkak të pengesave të njohura në këtë proces. Ëndrra jonë për paqe, gjithëpërfshirje gjinore dhe qeverisje demokratike është larg prej bërjes realitet.

Në vitin 2020, do të shënojmë 25 vjetorin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, 20 vjetorin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen dhe Sigurinë (UNSCR 1325) dhe gjithashtu pikën referuese 5-vjeçare drejt përmbushjes së Agjendës 2030 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshme (OZhQ).

Në sfondin e këtij momenti, ekziston një nevojë urgjente për të vlerësuar sfidat aktuale që ndikojnë në zbatimin e këtyre platformave të rëndësishme ndërkombëtare për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe kontributin e tyre në realizimin e plotë të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Ballkani Perëndimor vazhdon të ballafaqohet me një paqe të papërfunduar, demokraci të brishtë, siguri të brishtë, korrupsion, papunësi. Çështja e ikjes së trurit po prek të gjithë rajonin, çka është një humbje e kapaciteteve duke e bërë të vështirë planifikimin dhe punën për zhvillim dhe prosperitet. Pabarazitë vazhdojnë në shumë fusha dhe veçanërisht shqetësuese është pabarazia gjinore. Për më tepër, vonesat në integrimin evropian dhe euro-atlantik të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor e kanë futur rajonin në një udhëkryq. Kapërcimi i këtyre sfidave kërkon aktivizimin e të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe gratë ofrojnë një aset strategjik, për të cilin autoritetet kombëtare dhe ndërkombëtare duhet të jenë të vetëdijshme.

Lobi Rajonal i Grave në Evropën Juglindore (LRGEJL), si një organizatë unike për ndërtimin e paqes, konsideron se fuqizimi i grave dhe barazia gjinore ndihmojnë në krijimin e një themeli për rritje afatgjatë dhe një shoqëri paqësore, të drejtë dhe gjithëpërfshirëse. Ne mendojmë se ka ardhur koha për t'i dhënë pushtet grave dhe përpiqemi të sigurojmë ekuilibrin e fuqisë gjinore, ku gratë dhe burrat vendosin në mënyrë të barabartë dhe së bashku për një të ardhme të sigurt. Si organizatë që mbledh gra udhëheqëse në politikë dhe shoqëri civile nga vendet tona në focus: Kosova, Kroacia, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut, besojmë fuqishëm dhe punojmë për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore, për një të ardhme evropiane dhe euro-atlantike, për shtete dhe rajon paqësor, demokratik, të qëndrueshëm dhe të prosperuar.

Për t'iu përgjigjur mungesës së përparimit të vërtetë në fuqizimin e grave dhe paqëndrueshmërisë së vazhdueshme në rajon dhe me rastin e përvjetorëve përkatës - 25 vjetorit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, 20 vjetorit të Rezolutës 1325 të KS të OKB-së - **LRGEJL dhe UN Women, me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, do të organizojnë Konferencën**

Ndërkombëtare mbi Analizën Rajonale të platformës Pekini+25 për Ballkanin Perëndimor, në përputhje me Agjendën 2030 dhe Barazinë e Grave të Gjeneratës së KB-së.

2. Çështjet kryesore për t'u adresuar

Në këtë drejtim, LRGEJL konsideron se disa nga çështjet kryesore që kërkojnë ndërmarrjen e hapave të nevojshëm janë:

- **Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë i grave në qeverisje dhe vendimmarrje, në nivelin kombëtar dhe lokal, që çon në një qeverisje të shëndoshë dhe të mire e pa korrupsion, për interesin e qytetarëve.** Gratë duhet të luajnë rol kryesor në procesin e vendosjes për të ardhmen e bazuar në qeverisjen gjithëpërfshirëse demokratike gjinore dhe në ndërtimin e paqes për të mirën e qytetarëve. Sigurimi i barazisë gjinore në vendimmarrje kërkon një vullnet politik dhe garanci ligjore për zbatim. Kontributi i grave për të bërë ndryshime nga lufta në paqe në vendin tonë dhe në tërë Ballkanin duhet të njihet plotësisht. Këto gra si udhëheqëse dhe aktiviste me punën e tyre kanë demonstruar udhëheqje për ndryshim. Ato janë faktor ndryshimesh për një të ardhme më të mirë.
- **Konsolidimi i pjesëmarrjes domethënëse të grave në ndërtimin e paqes, tryezat e bisedimeve, ndërmjetësim dhe proceset e sigurisë që mund të rezultojnë në më shumë paqe, stabilitet dhe prosperitet.** Gratë duhet të luajnë rol kryesor në procesin e vendosjes për paqen dhe zbatimin e paqes në nivel kombëtar, lokal dhe ndërkombëtar, sepse vetëm paqja gjithëpërfshirëse gjinore mund të jetë e qëndrueshme. Nën-përfaqësimi i theksuar tejmase në krijimin e paqes, negociatat për paqe dhe ndërtimin e paqes nuk mund të tolerohen më. Statistika e habitshme që vetëm 2% e grave aktualisht shërbejnë si ndërmjetëse, kaq shumë vite pas miratimit të rezolutës 1325, flet vetë. Mungesa e theksuar e grave në negociatat zyrtare të paqes zbulon një hendek shqetësues midis aspiratave dhe realitetit të proceseve të paqes.
- **Sigurimi i qasjes së barabartë në drejtësi dhe drejtësinë kalimtare për gratë çon në paqe dhe pajtim të qëndrueshëm, shumë i nevojshëm në mjediset pas konfliktit.** Çështja e qasjes së barabartë në drejtësi për gratë, si kategoria më e cenueshme mbetet akoma shqetësuese. Ekziston një domosdoshmëri për të krijuar institucione të drejtësisë të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në aspektin gjinor për të fituar besimin në to, konsoliduar drejtësinë kalimtare për të vendosur drejtësi për viktimat, drejtësi e cila njihet dinjitetin e tyre si qytetarë dhe si qenie njerëzore, vendosjen e drejtësisë ndërkombëtare për gratë viktime të dhunës seksuale të lidhura me konflikte dhe, duke aplikuar lehtësimin/ndërmjetësimin si një mjet për të përmirësuar qasjen e barabartë të grave në drejtësi. Autoritetet kombëtare duhet të bëjnë shumë më tepër në këtë drejtim ndërsa mbesin të angazhuar për t'i dhënë fund diskriminimit, dhunës në familje dhe formave tjera të dhunës ndaj grave. Qasja në drejtësi është një e drejtë themelore e njeriut e përshkruar nga instrumente të shumta të OKB-së dhe BE-së për të drejtat e njeriut. Ajo çon në një shoqëri të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

3. Qëllimi dhe objektivat e Konferencës Ndërkombëtare

Qëllimi i Konferencës Ndërkombëtare është të rishikoj dhe diskutoj lidhur me tendencat kryesore dhe të paraqesë rekomandime për mbylljen e hendekut në barazinë gjinore në rajonin tonë dhe

më gjerë. Fokusi do të vihet në fushat e vendimmarrjes, ndërtimit të paqes, sigurisë dhe drejtësisë në Ballkanin Perëndimor, ku gratë ballafaqohen me sfida specifike duke pasë parasyshë kontekstin specifik të rajonit pas konfliktit.
Konferenca Ndërkombëtare ka **objektivat** si në vijim:

- **Të sjellë së bashku gratë udhëheqëse nga fusha e politikës, shoqërisë civile dhe eksperte për të diskutuar arritjet dhe sfidat e grave** në kontestin e periudhës post konfliktuale në lidhje me zbatimin e **Deklaratës së Pekinit dhe Platformës së vitit 1995** për fushat e të drejtave të grave, paqen dhe sigurinë të ndërlidhura me Rezolutën 1325 të OKB-së. Diskutimet do të bazohen në gjendjen e statusit të grave në 25 vjetorin e Konferencës së Pekinit, bazuar në analizat e bëra të Raporteve Kombëtare për platformën Pekini+25 të shtatë vendeve në fokus të LRGEJL. Gjetjet e diskutimeve pritet të gjenerojnë rekomandime për mbylljen e boshllëkut në barazinë gjinore në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke siguruar një kontribut rajonal për Platformën e ardhshme për Veprim Pekini+25.
- **Të përgatis një dokument përfundimtar - Raport dhe Rekomandime të aspektit Rajonal lidhur me platformën Pekini+25 për Ballkanin Perëndimor** – duke përshkruar arritjet dhe sfidat kryesore përkatëse të rajonit në lidhje me zbatimin e Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim në fushën e të drejtave të grave, paqes dhe sigurisë dhe paraqitjen e sugjerimeve e rekomandimeve shteteve lidhur me hapat për të ardhmen drejtë barazisë gjinore, në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe Barazinë e Grave të Gjeneratës së OKB-së.

4. Metodologjia dhe pjesëmarrësit

Konferenca Ndërkombëtare do të sjellë sëbashku rreth 50 pjesëmarrës në përbërje të:

- Grave udhëheqëse në fushën e politikëbërjes dhe shoqërisë civile, anëtare të parlamentit, të qeverisë së nivelit qendror e lokal, eksperte ndërkombëtare e vendore, Komitetin Drejtues të LRGEJL-së dhe të gjithë anëtarët tjerë të LRGEJL-së nga vendet në fokus, si: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia
- Përfaqësues të UN Women, Ambasada e Suedisë, agjensi tjera të OKB-së dhe organizata tjera ndërkombëtare.

Diskutimi në seancat plenare dhe në grupet e punës do të përqëndrohet në fushat e mëposhtme tematike:

Fusha tematike 1: Pjesëmarrja e barabartë e grave në vendimmarrje dhe qeveri

Fusha tematike 2: Pjesëmarrja e barabartë e grave në ndërtimin e paqes, pajtimin dhe proceset e sigurisë

Fusha tematike 3: Qasje e barabartë në drejtësi, drejtësi kalimtare dhe drejtësi ndërkombëtare për grate

5. Vendi dhe data e konferencës

Hotel "Holiday Inn", Shkup, Republika e Maqedonisë Veriore, më 26 nëntor 2019